LIGJ
Nr. 70/2016

PËR ZEJTARINË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon ushtrimin e veprimtarisë zejtare në Republikën e Shqipërisë, kualifikimin profesional në këtë fushë, si dhe organizimin e subjekteve zejtare nëpërmjet krijimit të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i ligjit është nxitja e zhvillimit të zejtarisë nëpërmjet mbrojtjes së interesave të zejtarëve dhe konsumatorëve të produkteve e të shërbimeve të zejtarisë, si dhe mbështetja për zhvillimin e kualifikimit profesional në këtë fushë.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Dhoma Kombëtare e Zejtarisë" është personi juridik që organizohet dhe vepron sipas këtij ligji.

2. "Organet e administratës qendrore dhe vendore" janë organet testuese dhe inspektuese të fushave të ndryshme, të lidhura me zejtarinë, që operojnë në treg, në bazë të kompetencave të përcaktuara në ligjet përkatëse.

3. "Regjistri i subjekteve zejtare" është regjistri që mban Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, në të cilin regjistrohen personat fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë veprimtari zejtare në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. "Subjekt zejtar" është një person fizik apo juridik, siç përcaktohet në Kodin Civil, që prodhon të mira dhe realizon shërbime zejtare, sipas listës së profesioneve në zejtari. Në veprimtarinë zejtare procesi i punës nuk është i automatizuar në një shkallë të lartë ose nuk është i ndarë në shkallë të lartë në hallka të veçanta, ashtu siç është tipike për prodhimin industrial në seri. Kjo kërkon një kualifikim zejtar të punonjësve.

5. "Veprimtari zejtare", janë:

a) zejtaria e shërbimit, që është mirëmbajtja dhe riparimi i stabilimenteve, linjave të prodhimit, pajisjeve e makinerive, objekteve, si dhe kryerja e shërbimeve të tjera;

b) zejtaria prodhuese, që është përpunimi dhe prodhimi i produkteve për treg, që nuk kanë veçori të prodhimit industrial;

c) zejtaria tradicionale, që është krijimi ose rikrijimi i objekteve të caktuara në mënyrë joindustriale, në sasi të vogla, bazuar kryesisht në punën me dorë dhe dijebërjen e trashëguar të vendit tonë, sipas përkufizimit të pasurive kulturore jomateriale, të përcaktuara në ligjin për trashëgiminë kulturore. Këtu përfshihen artizanati dhe artizanati shtëpiak.

6. "Zejtaria" është veprimtaria ekonomike, nëpërmjet së cilës prodhohen të mira dhe/ose realizohen shërbime zejtare përmes punës me dorë ose në seri dhe, në disa raste, duke përdorur aftësitë krijuese.

KREU II
PRODUKTET KULTURORE

Neni 4
Trashëgimia shqiptare

Produktet e veprimtarisë zejtare tradicionale respektojnë në mënyrë të përpiktë modelet e shpallura dhe të regjistruara si pasuri e trashëgimisë kulturore shqiptare. Shumëfishimi dhe riprodhimi i këtyre modeleve bëhet sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

Neni 5
Zonat e trashëgimisë

Ndalohet shitja e objekteve me natyrë kulturore-artistike të importuara, në zonat e shpallura "Qendra historike apo arkeologjike", sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore, pas 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

KREU III
USHTRIMI I VEPRIMTARISË ZEJTARE

Neni 6
Ushtrimi i veprimtarisë zejtare

1. Subjektet zejtare u nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi për regjistrimin dhe licencimin, kur është rasti, si dhe dispozitave të legjislacionit fiskal, për kategorinë e tatimpaguesve, së cilës ato i përkasin.

2. Ushtrimi i veprimtarisë zejtare në mënyrë të pavarur nga një person, organizatë ose nga një shoqëri është i lejuar vetëm nëse ata janë regjistruar në Dhomën Kombëtare të Zejtarisë.

3. Subjekti zejtar, që është i regjistruar sipas pikës 1, të këtij neni, detyrohet të ekspozojë në një vend të dukshëm vërtetimin e regjistrimit dhe t'ua tregojë atë personave të interesuar.

Neni 7
Shtetasit e huaj

Shtetasit e huaj zejtarë, që duan të ushtrojnë aktivitetin e zejtarisë në Republikën e Shqipërisë, duhet t'i nënshtrohen regjistrimit në Dhomën Kombëtare të Zejtarisë dhe të kalojnë provimin e kualifikimit ose të bëjnë njohjen e nivelit të kualifikimit që ata disponojnë në vendet e tyre.

Neni 8
Lista e profesioneve zejtare

Lista e profesioneve zejtare hartohet nga ministria përgjegjëse për kualifikimin profesional dhe Dhoma Kombëtare të Zejtarisë. Kjo listë i referohet Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, të përcaktuar nga Instituti i Statistikave, dhe është pjesë e Listës Kombëtare të Profesioneve, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9
Kushtet për ushtrimin e veprimtarisë zejtare

1. Subjekti zejtar duhet të ketë seli dhe mjedis të veprimtarisë zejtare, kur këtë e kërkon natyra e punës.

2. Nëse për kryerjen e veprimtarisë zejtare nuk është i nevojshëm mjedisi i veprimtarisë zejtare, atëherë seli e zejtarit konsiderohet vendqëndrimi i tij.

3. Subjekti zejtar mund të ushtrojë vetëm atë veprimtari zejtare, e cila është pasqyruar në

regjistrin përkatës pranë autoritetit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e biznesit.

4. Për çdo veprimtari zejtare duhet të ketë të paktën nga një mjeshtër ose person që plotëson kushtet e nenit 43 të këtij ligji.

5. Subjekti zejtar është i detyruar, që:

a) veprimtarinë zejtare ta ushtrojë në përputh-shmëri me ligjin dhe rregullat e marrë-dhënieve të punës;

b) gjatë kryerjes së veprimtarisë, të zbatojë dispozitat për masat e sigurisë e të mbrojtjes në punë, si dhe për mbrojtjen e mjedisit e zhvillimin e qëndrueshëm.

Neni 10

Ushtrimi i përbashkët i veprimtarisë zejtare

1. Dy apo më shumë persona fizikë mund të ushtrojnë veprimtari të përbashkët zejtare.

2. Marrëdhëniet dhe përgjegjësitë e personave, sipas pikës 1 të këtij neni, rregullohen me kontratë, të cilën palët kontraktuese ia dorëzojnë organit kompetent për të marrë lejen/licencën dhe për t'u regjistruar në regjistrin përkatës pranë autoritetit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e biznesit.

3. Në kontratën, sipas pikës 2 të këtij neni, zbatohen dispozitat ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet e punës në partneritet.

KREU IV

KUALIFIKIMI NË ZEJTARI

Neni 11

Ndihmësit

1. Ndihmësit janë persona që punojnë pranë një subjekti zejtar dhe mësojnë një zeje.

2. Ndihmësit mund të kualifikohen vetëm nga mjeshtrit ose personat që kanë një kualifikim ekuivalent apo eksperiencën e nevojshme. Për ekuivalencën apo eksperiencën vendos Dhoma Kombëtare e Zejtarisë në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për kualifikimet profesionale.

3. Ndihmësit kualifikohen në mjedis të dyfishtë, në mjedis pune, ku procesi i të nxënit realizohet vetëm nga mjeshtrit, dhe në institucione arsimore përmes shfrytëzimit të infrastrukturës arsimore, përfshirë edhe mësuesit.

4. Si ndihmës mund të pranohen:

a) personat që kanë mbushur moshën minimale për punë;

b) personat që ndjekin arsimin e mesëm profesional dhe dëshirojnë të kryejnë kualifikimin si ndihmës.

Neni 12

Kushtet për kualifikimin e ndihmësve

1. Ndihmësit mund të kualifikohen vetëm në zejet që ushtrohen në subjektet zejtare.

2. Të drejtën për të realizuar kualifikimin e kanë vetëm subjektet zejtare, të licencuara për këtë qëllim, të cilat vënë në dispozicion një mjedis të përshtatshëm si për llojin, ashtu edhe për bazën materiale të zejes.

3. Numri i ndihmësve përcaktohet në bazë të kapaciteteve për kualifikim dhe nevojave të subjektit zejtar, por nuk duhet të jetë më shumë se pesë ndihmës njëkohësisht.

4. Koha që i duhet ndihmësit për kualifikimin me njohuritë praktike pranë një mjeshtri dhe me njohuritë teorike në një institucion arsimor përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Kualifikimi i ndihmësve

1. Kualifikimi i ndihmësve në zejtari bëhet në bazë të rregullave të një programi mësimor, si dhe në përputhje me standardet e kualifikimeve që lidhen me përshkruesit e niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë bashkëpunon me agjencinë përgjegjëse për kualifikimet profesionale për hartimin e standardeve të kualifikimeve profesionale dhe kurrikulave përkatëse.

2. Ndihmësi mund të kualifikohet vetëm nëse ai nënshkruan një kontratë me subjektin zejtar.

3. Modeli i kontratës që lidhet mes ndihmësit dhe subjektit zejtar miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe duhet kryesisht të përmbajë:

a) kohëzgjatjen e kualifikimit;

b) objektin e kualifikimit (zeja që do të mësohet);

c) pagesën për punën që do të kryejë si ndihmës;

ç) marrëdhëniet e punës ndërmjet ndihmësit dhe pronarit të subjektit zejtar, siç përcaktohen në legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës;

d) njohjen e statusit të ndihmësit si nxënës dhe garantimin e një kualifikimi me cilësi.

Neni 14

Mbrojtja e ndihmësve të mitur

Mbrojtja e ndihmësve të mitur gjatë marrëdhë-nieve të punës dhe procesit të kualifikimit bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon marrë-dhëniet e punës.

Neni 15

Përfundimi i kualifikimit të ndihmësit

Kualifikimi i ndihmësit mbyllet me provimin për titullin e ndihmësmjeshtrit dhe certifikimin përkatës.

Neni 16

Ndihmësmjeshtri

1. Ndihmësmjeshtri është një person, i cili ushtron një zeje pranë një subjekti zejtar, si i punësuar pranë një mjeshtri dhe jo i pavarur.

2. Ndihmësmjeshtër mund të jetë:

a) një ndihmës që ka kaluar me sukses provimin për titullin e ndihmësmjeshtrit;

b) një person, i cili nuk është kualifikuar si ndihmës në një subjekt zejtar, por që ushtron zejen prej të paktën tre vjetësh dhe ka kaluar me sukses provimin për titullin e ndihmësmjeshtrit;

c) një person, i cili zotëron një kualifikim profesional ekuivalent me ndihmësmjeshtrin. Për ekuivalencën vendos Dhoma Kombëtare e Zejtarisë në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për kualifikimet profesionale.

Neni 17

Fitimi i titullit "ndihmësmjeshtër"

1. Në provimin për fitimin e titullit "ndihmës-mjeshtër" përcaktohet nëse personi zotëron njohuritë teorike dhe aftësitë praktike të nevojshme për ushtrimin jo të pavarur të zejes përkatëse.

2. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë lëshon certifikatën për titullin "ndihmësmjeshtër".

Neni 18

Mjeshtri

1. Certifikata e titullit "mjeshtër" jepet pas kalimit me sukses të provimit të kualifikimit.

2. Mjeshtër mund të jetë:

a) një ndihmësmjeshtër që ka ushtruar, si i tillë, zejen përgjatë tri viteve;

b) një person që ka një diplomë të shkollës së mesme profesionale ose të një niveli më të lartë në zejen përkatëse.

3. Certifikata e titullit "mjeshtër" lëshohet nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë.

4. Nuk ka kufizime për numrin e certifikatave të mjeshtrit që lejohet të zotërojë një person.

Neni 19

Vlerësimi dhe certifikimi i ndihmësmjeshtrit dhe mjeshtrit

1. Rregullorja për zhvillimin e provimit, si dhe ngritja e komisioneve përkatëse për vlerësimin, për fitimin e titullit "ndihmësmjeshtër" dhe "mjeshtër" hartohet nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për kualifikimet profesionale dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

2. Përmbajtja dhe formati i certifikatës për titullin "ndihmësmjeshtër" dhe "mjeshtër" miratohet me urdhër nga ministri përgjegjës për kualifikimin profesional.

Neni 20

Tarifa e provimit për titullin e ndihmësmjeshtrit dhe mjeshtrit

1. Shpenzimet për dhënien e provimit për titullin "ndihmësmjeshtër" dhe "mjeshtër" i mbulon personi që i nënshtrohet provimit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

2. Ministri përgjegjës për kualifikimin profesi-onal, me propozimin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, përcakton me udhëzim tarifat e dhënies së provimit për titullin "ndihmësmjeshtër" dhe "mjeshtër". Në përcaktimin e tarifave ministri përgjegjës për kualifi-kimin profesional mban parasysh politikat përfshirëse për grupet e veçanta, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

3. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për kualifikimet profesionale organizojnë dhe mbikëqyrin provimin për titullin "ndihmës-mjeshtër" dhe "mjeshtër".

4. Dy vitet e para, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, tarifa e provimit për titullin "ndihmësmjeshtër" dhe "mjeshtër" është falas.

Neni 21

Ankimi

1. Vendimet e komisioneve të vlerësimit mund të ankimohen në komisionin e apelimit, i cili ngrihet nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për kualifikimet profesionale.

2. Rregullorja e komisionit të apelimit miratohet nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë.

3. Vendimet e komisionit të apelimit mund të ankimohen në organet gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 22

Regjistri i ndihmësit, ndihmësmjeshtrit dhe mjeshtrit

1. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë mban regjistrin për ndihmësit dhe ndihmësmjeshtrit, që kualifikohen në subjektet zejtare.

2. Çdo subjekt zejtar është i detyruar të dërgojë për regjistrim çdo ndihmës apo ndihmësmjeshtër, menjë-herë sapo nënshkruhet kontrata përkatëse, sipas përca-ktimeve të nenit 13, pikat 2 dhe 3 të këtij ligji.

3. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë mban regjistrin për mjeshtrit.

4. Procedurat e regjistrimit dhe përmbajtja e të dhënave që regjistrohen në regjistrat, sipas pikave 1 dhe 3, të këtij neni, përcaktohen në rregullore, e cila miratohet nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë.

5. Listat me emrat e ndihmësve, ndihmës-mjeshtërve dhe mjeshtërve të regjistruar në këta regjistra i njoftohen ministrisë përgjegjëse për kualifikimin profesional.

KREU V
ORGANIZIMI I SUBJEKTEVE ZEJTARE

Neni 23
Dhoma Kombëtare e Zejtarisë

1. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë është person juridik që nuk ushtron veprimtari fitimprurëse.

2. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë mbështet dhe përfaqëson interesat e përbashkët të anëtarëve të saj dhe ndikon në krijimin dhe forcimin e imazhit të subjekteve zejtare.

3. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë mund të blejë dhe të zotërojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në funksion të nevojave të saj.

4. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë ka selinë në Tiranë dhe mund të hapë degë të saj në qarqe të ndryshme të vendit, kur e gjykon të nevojshme.

Neni 24
Anëtarët

1. Anëtarë të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, janë:

a) subjektet zejtare;

b) mjeshtrit, ndihmësmjeshtrit dhe ndihmësit.

2. Anëtarët e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, me përjashtim të ndihmësit, duhet të paguajnë një kuotë anëtarësimi, bazuar në rregulloren e kuotizacionit dhe kushtet e përcaktuara në statutin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, si dhe në vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 25
Detyrimi për t'u regjistruar

Çdo subjekt zejtar detyrohet të regjistrohet në Dhomën Kombëtare të Zejtarisë.

Neni 26
Kompetencat e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë

Dhoma Kombëtare e Zejtarisë ka këto kompetenca:

a) përfaqëson interesat e subjekteve zejtare dhe i mbështet ato duke u siguruar një trajtim të drejtë e të barabartë;

b) propozon dhe merr pjesë në hartimin dhe përpunimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e zejtarisë dhe kualifikimit profesional në zejtari;

c) mbështet anëtarët e saj në organizimin dhe zhvillimin e sistemit të kualifikimit profesional për zejtarë;

ç) organizon dhe mbikëqyr, në bashkëpunim me agjencinë përkatëse të kualifikimeve profesionale, provimet për fitimin e titujve, si dhe lëshon certifikatat për titullin "ndihmësmjeshtër" dhe "mjeshtër";

d) koordinon procesin e kualifikimit në zejtari dhe mbikëqyr zbatimin e tij, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për kualifikimin profesional;

dh) u ofron këshillime ligjore subjekteve zejtare që janë anëtarë të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë;

e) lehtëson vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet subjekteve zejtare,

zejtarëve, dhe subjekteve të biznesit që janë të interesuar për të përdorur produkte zejtare në veprimtarinë e tyre fitimprurëse, nëpërmjet organizimit të panaireve, publikimit të regjistrit të subjekteve zejtare, lobimit pranë biznesit vendas dhe ndërkombëtar për produktet zejtare vendase;

ë) promovon produktet zejtare vendase, brenda dhe jashtë vendit;

f) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të vendeve të tjera për standardizimin ose njohjen e certifikatave të ndihmësmjeshtrit dhe mjeshtrit edhe jashtë vendit;

g) administron regjistrin e subjekteve zejtare, mjeshtërve dhe ndihmësmjeshtërve e ndihmësve;

gj) informon autoritetet përkatëse shtetërore për çështje të ndryshme që lidhen me zejtarinë.

Neni 27

Statuti

Veprimtaria e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, rregullat për zgjedhjen, funksionimin e organeve të saj, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe aktet që ato nxjerrin rregullohen nga Statuti i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, i cili duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi dhe në të përcaktohen:

a) adresa e selisë së dhomës, fusha e veprimtarisë, anëtarësimi i subjekteve, kriteret dhe kuota e anëtarësimit, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të saj;

b) mënyra e organizimit, funksionet, përbërja dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese;

c) rregullat për zgjedhjen e përfaqësuesve të asamblesë, anëtarëve të kryesisë dhe presidentit, si dhe arsyet e rregullat për mbarimin e mandatit të tyre;

ç) kuorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e mble-dhjeve të organeve të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, që është më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve, si dhe kuorumi i nevojshëm për realizimin e vendimmarrjes së tyre;

d) burimet financiare, mënyra e administrimit dhe e kontrollit të tyre, përfaqësimi dhe marrëdhëniet e dhomës me të tretët;

dh) rregullat për organizimin e mbledhjeve, njoftimi, pjesëmarrja, mënyra dhe procedura e votimit për marrjen e vendimeve;

e) mënyra e miratimit të ndryshimeve në statut;

ë) rregullat për caktimin e shpërblimeve për të punësuarit e dhomës;

f) marrëdhëniet me ministrinë përgjegjëse për kualifi-kimet profesionale.

Neni 28

Organet

Organe të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, janë:

a) Asambleja e Përgjithshme;

b) kryesia;

c) Presidenti i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë;

ç) komisionet.

Neni 29

Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë është organi më i lartë drejtues dhe përbëhet nga përfaqësuesit e të gjithë anëtarëve të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, sipas një kuote përfaqësimi, që përcaktohet në statutin e dhomës.

2. Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë ka këto përgjegjësi:

a) miraton statutin me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të saj dhe ia paraqet ministrit përgjegjës për kualifikimin profesional për miratim brenda 30 ditëve. Statuti hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga ministri, i cili, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, duhet ta miratojë atë ose t'i kërkojë dhomës ndryshimin e dispozitave që nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Statuti konsiderohet i miratuar nëse ministri nuk kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për miratim;

b) emëron ose shkarkon nga detyra Presidentin e Dhomës, sipas procedurave të përcaktuara në statut;

c) zgjedh ose shkarkon anëtarët e kryesisë së dhomës, sipas procedurave të përcaktuara në statut;

ç) emëron ose shkarkon nga detyra anëtarët e komisioneve, sipas procedurave të përcaktuara në statut;

d) përcakton normat e tarifave për shërbimet;

dh) miraton buxhetin dhe bilancin vjetor;

e) miraton rregullat për kualifikimin në zejtari në marrëveshje me shoqatat kombëtare përgjegjëse dhe me ministrinë përgjegjëse për kualifikimin profesional, që është përgjegjëse për mbikëqyrjen;

ë) i propozon ministrisë përgjegjëse për kuali-fikimin profesional ndryshime legjislative.

Neni 30

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë thirret të paktën dy herë në vit. Ajo mund të thirret me kërkesë të një të tretës së anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme ose të Presidentit të Dhomës.

2. Thirrja, organizimi dhe procedurat e zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjith-shme Kombëtare të Zejtarisë bëhen sipas përcaktimeve të statutit dhe rregulloreve.

3. Në qoftë se Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet edhe pas kërkesës së një të tretës ose presidentit, atëherë kjo mund të bëhet nga ministri përgjegjës për kualifikimin profesional.

Neni 31

Kryesia dhe përbërja e kryesisë

1. Kryesia është organi ekzekutiv i dhomës. Ajo zbaton vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe ka këto kompetenca:

a) miraton programet e punës, që lidhen me detyrat dhe objektivat e dhomës;

b) miraton strukturën organizative të admini-stratës së dhomës, funksionet dhe pagat e punonjësve të saj;

c) shqyrton programin vjetor financiar dhe buxhetin përpara se t'i paraqitet asamblesë për miratim;

ç) cakton rregullat për përdorimin e fondeve dhe administrimin e tyre;

d) emëron komisionet e provimeve për titullin "mjeshtër" dhe "ndihmësmjeshtër";

dh) propozon ndryshimet në statutin e dhomës;

e) përcakton rendin e ditës së mbledhjes së asamblesë së dhomës.

2. Kryesia e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë përbëhet nga Presidenti i Dhomës dhe nga anëtarët që zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë. Numri i anëtarëve të kryesisë, kriteret dhe procedura e zgjedhjes së tyre përcaktohen në Statutin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë. Anëtarë të kryesisë mund të jenë vetëm përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.

3. Vendimet e kryesisë janë të vlefshme kur për to votojnë pro më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

4. Në rast dorëheqjeje, vdekjeje ose shkarkimi të anëtarëve të kryesisë, anëtarët e rinj të kësaj kryesie zgjidhen duke u bazuar në pikën 2 të këtij neni, nga radhët e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme. Anëtarët e rinj të zgjedhur e ushtrojnë detyrën për pjesën e mbetur të periudhës kohore.

5. Kryesia e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë mund të krijojë struktura, që mbështetin

veprimtarinë e saj.

Neni 32

Presidenti i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë

1. Presidenti i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë drejton veprimtarinë e dhomës dhe kryesinë e saj. Presidenti emërohet dhe shkar-kohet nga asambleja.

2. Ai është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.

3. Presidenti përfaqëson dhomën në marrë-dhëniet me të tretët, sipas përcaktimeve të statutit dhe legjislacionit në fuqi.

4. Presidenti i Dhomës mund të zgjidhet çdo shtetas shqiptar, që ka zotësi të plotë për të vepruar, ka mbaruar arsimin e lartë, është anëtar i dhomës, si dhe plotëson kriteret e tjera, të përcaktuara në statutin e dhomës.

5. Presidenti ka mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë. Procedura e zgjedhjes apo e shkarkimit të tij përcaktohet në statutin e dhomës.

Neni 33

Komisionet

Dhoma Kombëtare e Zejtarisë mund të zgjedhë komisione për detyra të veçanta. Numri i anëtarëve dhe procedura e zgjedhjes përcaktohen në statut. Komisionet zgjedhin një kryetar nga radhët e anëtarëve të dhomës.

Neni 34

Tarifat e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë

1. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë vendos tarifa për shërbimet që ofron.

2. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë përjashton nga tarifat subjektet zejtare që janë ndërmarrje sociale.

3. Vlera e tarifave përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe me miratim të ministrisë përgjegjëse për kualifikimin profesional.

KREU VI

REGJISTRI I SUBJEKTEVE ZEJTARE

Neni 35

Regjistri i subjekteve zejtare

1. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë mban një regjistër të subjekteve zejtare që veprojnë në të gjithë territorin e vendit.

2. Në regjistër shënohen të gjitha subjektet zejtare me statuset si persona fizikë ose juridikë.

3. Regjistri i subjekteve zejtare organizohet sipas modelit dhe përmbajtjes së të dhënave, të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për kualifikimin profesional, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Zejtarisë.

4. Regjistrimi bëhet kundrejt pagesës së një tarife, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

Neni 36

Kërkesa për regjistrim

1. Regjistrimi në regjistrin e subjekteve zejtare bëhet me kërkesë të pronarit të subjektit zejtar ose të personit, i cili vazhdon veprimtarinë e subjektit zejtar.

2. Kërkesës për regjistrim i bashkëlidhen:

a) dëshmia e provimit për titullin "mjeshtër" dhe/ ose dokumente të tjera që dëshmojnë për përmbushjen e kushteve që mundësojnë licencimin e subjektit si subjekt zejtar, si dhe bëjnë të mundur vazhdimin e veprimtarisë së subjektit zejtar në rastet e parashikuara në ligj;

b) një kopje e certifikatës së regjistrimit, kur është rasti, në autoritetin përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e biznesit;

c) një dokument që vërteton miratimin nga ana e mjeshtrit për të marrë drejtimin e subjektit zejtar;

ç) dëshmia që i jep të drejtën e përfaqësimit personit që ka nënshkruar kërkesën;

d) mandati për tarifën e paguar ose vërtetimi për përjashtimin nga pagesa e tarifës.

Neni 37

Regjistrimi nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë

1. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë vendos brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës për regjistrim.

2. Në rast se të dhënat në aplikimin e dorëzuar nuk janë të plota dhe/ose kanë gabime, aplikuesit i kërkohet me shkrim që brenda një afati prej shtatë ditësh t'i rregullojë dhe t'i plotësojë ato.

3. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë mund të ushtrojë kontrolle për të verifikuar saktësinë e të dhënave dhe dokumenteve të dorëzuara, si dhe të marrë informa-cione të tjera për aplikuesin nëpërmjet rrugëve zyrtare.

4. Personit të regjistruar i jepet një dëshmi bazuar në një model, i cili miratohet nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë.

Neni 38

Çregjistrimi nga regjistri i subjekteve zejtare

1. Çregjistrimi nga regjistri i subjekteve zejtare bëhet:

a) me kërkesë të personit të regjistruar, të trashëgim-tarëve ose të pasuesve ligjorë;

b) me vdekjen e personit, me mbylljen ose likuidimin e organizatës ose të shoqërisë.

2. Në rastet e pikës 1 të këtij neni, bëhet një shënim në regjistër për mbylljen e subjektit zejtar.

KREU VII

MASAT PËR NXITJEN DHE ZHVILLIMIN E ZEJTARISË

Neni 39

Bashkëpunimi me Dhomën Kombëtare të Zejtarisë

Organet e pushtetit qendror dhe vendor bashkë-punojnë me Dhomën Kombëtare të Zejtarisë për plotësimin e objektivave të ligjit dhe shkëmbejnë informacionet e domosdoshme.

Neni 40

Financimi i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë

Dhoma Kombëtare e Zejtarisë financohet, nga:

a) kuotat e anëtarësisë;

b) tarifat për shërbimet që ajo ofron;

c) çdo financim tjetër i ligjshëm (donatorët).

KREU VIII

MBIKËQYRJA

Neni 41

Mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve tjera realizohet nga ministria përgjegjëse për kualifikimin profesional.

KREU IX
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 42

1. Subjektet zejtare, që kanë ushtruar veprimtarinë e tyre zejtare sipas dispozitave të mëparshme ligjore, detyrohen që veprimtarinë e tyre zejtare ta harmoni-zojnë me dispozitat e këtij ligji, brenda një afati 3-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së zejtarëve që nuk zbatojnë përcaktimin e bërë në pikën 1 të këtij neni.

Neni 43

1. Brenda një periudhe pesëvjeçare pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kërkesën e personave, regjistrohen në regjistrin e mjeshtrit edhe ata që kanë diplomë, e cila mund të njihet si ekuivalente me provimin për titullin "mjeshtër", sipas legjislacionit në fuqi.

2. Kriteret dhe procedurat e njohjes së të nxënit të mëparshëm miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për kualifikimin profesional, me propozim të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, në bashkëpunim me Agjencinë përgjegjëse për kualifikimin profesional.

Neni 44
Organizimi i zgjedhjeve të para

1. Ministri përgjegjës për kualifikimin profesional ngarkohet të ngrejë një komision të përkohshëm, detyra e të cilit është të organizojë zgjedhjet e para të Kryesisë së Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në përbërje të këtij komisioni duhet të ketë edhe zejtarë.

2. Me zgjedhjen e kryesisë së dhomës, komisioni i përkohshëm shkrihet automatikisht.

Neni 45
Financimi fillestar

Dhoma Kombëtare e Zejtarisë subvencionohet nga shteti për një periudhë 2-vjeçare, duke filluar që nga momenti i zgjedhjes së kryesisë së dhomës.

Neni 46
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12, pika 4 dhe 13, pika 3, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për kualifikimin profesional që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet normative në zbatim të neneve 8; 19, pika 2; 20, pika 2; 35, pika 3; 43, pika 2; dhe 44, pika 1, të këtij ligji.

Neni 47
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.6.2016

Shpallur me dekretin nr. 9684, datë 11.7.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani